



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 16- 9527 /16
Kaçanik, 30.03.2016

RREGULLORE NR. 02/2016
PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE

Mars, 2016

Në bazë të nenit, 5 lidhur me nenet, 12.1, 12.2 (c), 40.2 (a, g) dhe 17 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2 të Ligjit nr. 03/L - 215, mbi Qasjen në Dokumente Publik, nenit 34.5. të të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(f) të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.03.2016, miratoj këtë:

RREGULLORE Nr. 02/2016

PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat për hapjen e kutive të ankesave, shqyrtimin e ankesave, sugjerimeve, rekomandimeve dhe komenteve të parashtruara nga qytetarët.

Fushëveprimi Neni 2

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përcaktohen: vendosja e kutive, hapja e kutive, shqyrtimi i shkresave, formimi i komisionit për hapjen e kutive të ankesave, pranimi i sugjerimeve, rekomandimeve dhe komenteve që kanë të bëjnë me të punësuarit në Komunë, duke u bazuar në rregullativën në fuqi.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Vendvendosja e kutive të ankesave

Neni 3

3.1 Kutitë e ankesave vendosen në hyrje të institucioneve publike, në vend të hapur, ku mund të vërehen nga qytetarët.

3.2 Drejtoria për Administratë të Përgjithshme është e obliguar që të përkujdeset për vendosjen e kutive të ankesave dhe mirëmbajtjen e tyre.

Komisioni për hapjen e kutive të ankesave

Neni 4

4.1. Kryetari i Komunës emëron komisionin dhe kryesuesin e komisionit për hapjen e kutive të ankesave.

4.2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë me mandat një (1) vjeçar. Dy (2) anëtarë të komisionit duhet të jenë shërbyes civilë, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile, të cilët nuk duhet të jenë anëtar të ndonjë komiteti ose këshilli të Komunës.

4.3. Me rastin e caktimit të anëtarëve të komisionit, duhet pasur parasysh edhe përfaqësimin gjinor.

Procedura për hapjen e kutive të ankesave

Neni 5

5.1. Hapja e kutive të ankesave bëhet çdo të premte të fundit të muajit. Në rast se ajo ditë bie ditë pushimi, atëherë procedura e hapjes së kutive bëhet në ditën e parë të punës që pason.

5.2. Komisioni bënë ndarjen e ankesave (shkresat) në bazë të objektit të ankesës për drejtoritë përkatëse.

5.3. Çdo shkresë (ankesë, sugjerim, vërejtje) iu dorëzohet drejtorëve të drejtorive përkatëse, e nënshkruar nga drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, brenda afatit prej shtatë (7) ditëve të punës nga dita e hapjes së kutive.

5.4. Komisioni për hapjen e kutive të ankesave duhet t'i raportojë drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, pas çdo procedure të hapjes së kutive, duke mbrojtur anonimitetin e personave të përfshirë.

5.5. Çelësat e kutive të ankesave i mban drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

Neni 6

Qytetarët mund të ankohen:

6.1. Kundër vendimeve të organeve të Komunës;

6.2. Për shërbimet jo të mira;

6.3. Për refuzimin e shërbimeve;

6.4. Për heshtjen në marrjen e vendimeve (heshtje administrative);

6.5. Për sjelljet e punonjësve;

6.6. Për shkeljen ose cenimin e të drejtave të tyre dhe për të gjitha shkeljet që mendojnë se u janë bërë nga organet e administratës.

Neni 7

7.1. Komisioni, në afat prej tre (3) ditësh është i obliguar që të hartojë raportin për numrin e ankesave dhe natyrën e tyre, dhe atë t'ia dorëzojë drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

7.2. Pas pranimit të raportit nga komisioni, drejtori i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme obligohet që të veprojë konform paragrafit 5.3 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

7.3. Asnjë vendim administrativ nuk mund të ndërmerret në dëm të parashtruesit të ankesës, si pasojë e parashtrimit të ankesës.

7.4. Bazuar në Ligjin për përdorimin e gjuhëve, qytetari mund të bëjë ankesë, shkresa, rekomandime, sugjerime dhe komente në gjuhën zyrtare, të paraparë në Statutin e Komunës së Kaçanikut.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen organet e Administratës së Komunës.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

